



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:247767
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06773240

C.nr. 493/2015

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.H. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurve G.K. Sh.P.K., me NUI me seli në Prishtinë dhe M.B. nga Prishtina, që të dy të përfaqësuar sipas autorizimit nga Shoqëria e Avokatëve “K&V” Sh.P.K., K.P.K. i përfaqësuar sipas autorizimit nga B.M. dhe K.GJ.K. i përfaqësuar sipas autorizimit nga B.M., me objekt të kontestit mbi bazën e shpifjes dhe fyerjes dhe kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 260,000.00 euro (dyqindegjashtëdhjetë mijë), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik i mbajtur në prani të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datë 29.01.2025 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit H.H. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të: a), VËRTETOHET se të paditurit e parë G.K. Sh.P.K me seli në Prishtinë, dhe i padituri i dytë M.B. si autor i emisionit “P.” në bashkëkryerje, me veprime antiligjore kanë fyer dhe kanë shpif ndaj paditësit, duke publikuar të dhëna, dhe duke e gjykuar në media, në kundërshtim me ligjet në fuqi, kinse për faj rreth korrupsionit në Kosovë, pa ju dhënë mundësia paditësit nga mediumi në të njëjtin emision nga të paditurit, për të dëshmuar pafajësinë e tij në emisionin e publikuar me datë 22.12.2014, para auditorit të përgjithshëm, b), të DETYROHET i padituri i parë G.K. Sh.P.K me seli në Prishtinë që për shkak të shpifjes që ka bërë ndaj paditësit H.H., të njëjtit t’i paguajnë shumën prej 50.000,00 euro, (pesëdhjetë mijë), c), të DETYROHET e paditura e parë G.K. Sh.P.K, me seli në Prishtinë që për shkak të fyerjes që kanë bërë me deklaratatë të publikuara dhe të drejtuara ndaj paditësit H.H. në mënyrë nënçmuese dhe pa ju dhënë mundësia paditësit që të sqaron pafajësinë tij, t’i paguan shumën prej 50.000,00 euro (pesëdhjetë mijë), ç), të DETYROHET i padituri i dytë M.B., udhëheqës dhe autor i emisionit “P.” që në emër të shpifjes që ka bërë ndaj paditësit H.H., t’i paguaj shumën prej 25.000,00 euro (njëzetepesë mijë), d), të DETYROHET i padituri M.B. që në emër të fyerjes me publikimin e deklaratave ndaj paditësit H.H. të cilat ishin nënçmuese, paditësit t’i paguaj shumën prej 25.000.00 euro (njëzetepesë mijë), dh), të VËRTETOHET se të paditurat e tretë K.P.K., dhe e paditura e katërt K.GJ.K., me veprime, procedura të pa bazuara te pa mbështetura në prova dhe te tej zgjataura i kanë shkaktuar dëm material dhe jo material dhimbje shpirtërore te të gjitha intenziteteve paditësit duke cenuar integritetin dhe personalitetin e tij, e), të DETYROHET e paditura e tretë K.P.K. që për këto veprime dhe dëme, dhimbje shpirtërore te të gjitha intenziteteve, që i kanë shkaktuar paditësit t’i paguaj

shumën prej 50.000.00 (pesëdhjetë mijë), ë), të DETYROHET e paditura e katërt K.GJ.K. që për këto veprime dhe dhimbje shpirtërore të të gjitha intenziteteve që i ka shkaktuar paditësit t'i paguaj shumën prej 60.000,00 euro (gjashtëdhjetë mijë), e të gjitha këto me kamatë ligjore 8% në vit duke filluar nga data e shkaktimit të dëmit, kur është bërë publikimi i emisionit me datë 22.12.2014, e deri në pagesën definitive, si dhe f), të DETYROHEN të paditurat e parë dhe dytë që në të njëjtin medium në një interval kohor të shikueshmërisë më të lartë t'i kërkojnë falje paditësit për fyerjen dhe shpifjen, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET paditësi H.H. nga Prizreni, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të paditurës së parë G.K. Sh.P.K., me NUI ... me seli në Prishtinë, t'ia paguaj shumën 2,860.00 euro dhe të paditurit të dytë M.B. shumën 2,860.00 euro, në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paraqitja e padisë dhe pretendimet e palëve

Paditësi me datë 03 Mars 2015 ka paraqitur padi pranë kësaj gjykate fillimisht ndaj të paditurës së parë T.K.V. me seli në Prishtinë dhe të paditurit të dytë M.B. nga Prishtina duke kërkuar kompensimin e dëmit mbi bazën e shpifjes dhe fyerjes, ndërsa gjatë procedurës e ka zgjeruar padinë në aspektin subjektiv edhe ndaj të paditurës së tretë K.P.K. dhe të paditurës së katërt K.GJ.K., duke kërkuar kompensimin e dëmit në emër të dhimbjeve shpirtërore të shkaktuara si pasojë e zhvillimit të procedurës penale. Ndërsa, paditësi me parashtresën e datës 16.04.2024 të paditurës së parë T.K.V. i është referuar si G.K. Sh.P.K., në lidhje me këtë gjykata duke u bazuar në nenin 76 të LPK-së, nga regjistrat publik të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve, konstatoj se T.K.V. është njësi në kuadër të G.K. Sh.P.K., e cila identifikohet me numër unik identifikues, dhe e njëjta e ka cilësinë e palës.

Paditësi përmes padisë, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me datë 22.12.2014, në ora 20:15 minuta i padituri i dytë si udhëheqës i emisionit dhe person përgjegjës në të paditurën e parë në televizionin K., në emisionin me titull "P.i" i cili emision është përsëritë në kanalën "A.K.N", në të njëjtën datë në ora 22:00, të cilin emision e ka udhëheqë autori tani i padituri M.B., ku ka marrë pjesë në cilësinë e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Kosovës z. A.Sh. por pa prezencën e paditësit, dhe dhënien e mundësisë që të kundërpërgjigjet në pretendime të ngritura, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, konventat ndërkombëtare, në kundërshtim me ligjet në fuqi, dhe në kundërshtim me etiken e profesionit të prokurorit, ka shpjeguar aktakuzën të cilën e ka hartuar dhe e ka ngritur ndaj paditësit për publikun audiencën e gjerë, shikuesit e televizionit, të cilën aktakuzë ende nuk e ka pranuar paditësi, dhe as avokati i paditësit, dhe se vendi i shqyrtimit të pretendimeve të aktakuzës është gjykata dhe jo televizioni, i cili ka lejuar emetimin e emisionit bashkë me personin përgjegjës si autor i emisionit. Ka shtuar se, i padituri i dytë, me vetë faktin se gjatë emisionit lejon përmendjen e personave të tretë që nuk janë prezent në emision (këtu paditësit), lejon që prokurori gjatë të njëjtit emision të marrë aspekte politike, duke cituar perceptimin e opinionit publik për korrupsionin në Kosovë si dhe për radhitjen e

Kosovës me rang të lartë të korrupsionit, si dhe nuk tenton të marrë shpjegime / informacione shtesë lidhur me fyerjet dhe shpifjet e përdorura nga personat prezentë në emision, konsumojnë elementet e shpifjes e cila është e sanksionuar sipas ligjit, duke dëmtuar reputacionin e paditësit, e për çka ky i fundit është shtrënguar të japë edhe dorëheqje të parevokueshme nga puna dhe detyrat e punës. Ka theksuar se, i padituri i dytë, autori i emisionit gjithashtu ka qenë në dijeni se Aktakuza nuk nënkupton vetvetiu fajësinë e një personi, megjithatë ka lejuar të ftuarin prokurorin që të vazhdojë me shpjegimin e akuzave ndaj paditësit, kinse paditësi me të vërtetë është fajtorë për veprat të cilat iu kanë vënë në barrë, duke konsumuar kështu kuptimin ligjor të shpifjes: *“ka qenë dashur t'a dijë se deklarata është e pavërtetë”*, në të cilën të paditurit e parë dhe dytë janë thirr. Tutje ka shtuar se, sekuenca ku i padituri i dytë lejon përdorimin e personit të tretë në këtë rast paditësit, dhe e paditura e parë e emeton, pa qenë prezent i njëjti, janë në minutën e 48:08 deri 49:20 të emisionit, ku i ftuari prezent nga KDI thekson se paditësi ka shkelur ligjin në një rast, duke e favorizuar një OE të caktuar, minuta 49:24 deri 55:22 i emisionit, ku prokurori i shtetit, i punësuar nga i padituri i tretë - KPK, dhe me lejen e Kryeprokurorit, duke përmendur dhe shpjeguar aktakuzën ende të pa publikuar, konsumon në mënyrë të plotë përkufizimin e shpifjes dhe fyerjes të përcaktuar në nenin 3 të LCKSHF-së. Më tej, në vijim paditësi ka deklaruar se nga përfaqësuesi i të paditurit të parë dhe të dytë mund të thuhet se i padituri i dytë nuk ka mundur t'a dijë se paditësi emri i të cilit është përdorur në emisionin e tij, nuk ka kryer veprat për të cilat është akuzuar në emisionin e tij, mirëpo, si mund të theksojë i njëjti i paditur në emisionin e tij në minutën 59:29 deri 59:38 të emisionit, një rast tjetër të *“kalibrit të lartë”* siç e quan ai, dhe të theksojë se *“nuk mund t'a përmend në emision për shkak të sensitivitetit, dhe se emri i tij nuk bënë të publikohet”*, ndërsa për paditësin lejon që emri i tij të (keq) përdoret në emision, duke vepruar kështu me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e “lajmit”, si dhe duke shkelur kështu publikimin e arsyeshëm të paraparë me nenin 7 të LCKSH, Ka shtuar se, lidhur me shpifjet dhe fyerjet që i janë bërë paditësit nga të paditurit, në bazë të Ligjit nr. 04/L-44, për Komisionin e Pavarur për Media, Shërbimi Medial Audiovizel, ka parashtruar ankesë me propozim që në kuptim të të njëjtit, pas analizimit të ankesës të njëjtën të aprovon dhe t'i vendos gjobë transmetuesit dhe personave përgjegjës, të detyroj që të transmeton korigjimin dhe t'i kërkoj falje ankuesit. Tutje ka theksuar se, të paditurit e parë dhe të dytë me veprimet e tyre në bazë të provave në shkresat e lëndës kanë publikuar deklarime të pa vërteta, kuptimi i të cilave ka dëmtuar rëndë reputacionin e paditësit, deklarimet dhe publikimet e deklaratave të të paditurve të parë dhe të dytë ndaj paditësit janë bërë në mënyrë nënçmuese, për çka kanë konsumuar veprën e shpifjes.

Në raport me të paditurën e tretë dhe të katërt, paditësi ka deklaruar se të njëjtit me procedurë të pa bazuar në prova, të tej zgjatura në kohë kanë shkaktuar dëme shpirtërore të paditësi i cili është shtrënguar të jap dorëheqjeje të pa revokueshme nga pozita që ka mbajtur dhe është ballafaquar me procedura disa vite me radhë për të cilat me vendime përfundimtare gjyqësore është shpallur i pafajshëm. Ka deklaruar se, eksperti gjyqësor me ekspertizën e dhënë me shkrim dhe me përgjigjet në shqyrtim gjyqësor ka sqaruar se në bazë të dokumenteve mjekësore që datojnë nga viti 2015 e këndeje për paditësin i njëjti ka pësuar dhimbje shpirtërore të intenzitetit të lartë për 6 muaj, të intenzitetit të mesëm për 1 vit dhe dhimbje shpirtërore të

intenzitetit të ulët përjeton edhe tani dhe të njëjtat dhimbje janë të përvetshme. Tutje, në raport me bazën ligjore ka deklaruar se, baza ligjore për kompensim demi dhe publikim të demantimit për të paditurën e parë dhe të dytë është në Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes nr. 02/L-065, neni 1 pika c, neni 3 pika a, neni 4 pika 1, neni 5 pika 1, neni 14, dhe 15 të të njëjtit ligj, ndërsa baza për kërkim falje mbështetët, në Ligjin nr. 04/L-044, nenin 30, konstatuar dhe vërtetuar edhe nga KPM-ja. Kurse në raport me bazën ligjore për kompensimin e demit ka shtuar se e njëjta mbështetët në nenet 136.1,140, 182, dhe 183 të LMD-së, ndërsa lidhur me të paditurat e tretë dhe të katërt mbështetët në nenet 136 dhe 153 te LMD-së. Në seancën e shqyrtimit kryesor e ka precizuar kërkesën e padisë sikurse në dispozitiv të aktgjyqimit, dhe nga gjykata ka kërkuar që e njëjta të aprovohet në tërësi e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore shumë prej 501.00 euro, për ekspertizë shumë prej 155.00 euro, për përfaqësim në shtatë seanca nga 633.75 euro apo në shumë përgjithshme prej 5,725.00 euro.

E paditura e parë G.K. Sh.P.K me seli në Prishtinë përmes përgjigjes në padi, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj, duke shtuar se paditësi ka dështuar të paraqes se cilat kanë qenë thëniet apo deklaratimet shpifëse ose fyese të cilat e kanë shqetësuar, të vetmet elemente në të cilat thirret si bazë paditësi në padinë e tij janë: *“në emisionin e tillë të paditurat i kanë lejuar musafirrit - Prokurorit Special që gjatë të njëjtit emision të marr edhe aspekte politike, duke citu perceptimin e opinionit publik për korrupsionin në Kosovë, dhe duke shpjegu edhe barometra ndërkombëtar, për radhitjen e Kosovës në rangë të lartë të korrupsionit, dhe më pastaj duke shpjegu aktakuzën që ka ngrit ndaj ankuesit.”* Ka theksuar se, i vetmi rast gjatë emisionit në të cilin përmendet emri i paditësit, është në minutën e 49:29 ku moderatori i emisionit B. i drejtohet prokurorit të shtetit A.Sh. në formën pyetëse “çfarë ka keqpërdorë z. H.?” duke mos konstatuar asgjë, ndërsa më tutje prokurori i shtetit vazhdon të elaboroj në pika të shkurtra procesin e hetimeve si dhe rezultatin i cili ka shpie gjerë tek aktakuza kundër këtu paditësit, pra siç mund të vërejmë, ne pjesën e emisionit dhe deklaratimeve në të cilat përmendet z. H., ka vetëm një pyetje të parashtruar nga moderatori lidhur me të, si dhe një raportim të drejtë dhe të sakte të prokurorit të shtetit të një dokumenti zyrtar i cili rrjedh nga një hetim publik. Ka shtuar se, në një përmbajtje të tillë të deklaratimeve, edhe sikur në rastin më të mirë për paditësin të kishte elemente të shpifjes, në rastin konkret deklaratat e tilla prapëseprapë nuk do të bartnin përgjegjësi për faktin se të njëjtat janë të bëra në rrethanat sipas pikës i) të nenit 9 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pathemeltë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumë prej 325.00 euro dhe për përfaqësim në shtatë seanca shumë prej 422.50 euro për seancë, e në shumë përgjithshme prej 3,882.50 euro.

I padituri i dytë përmes përgjigjes në padi, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj, duke shtuar se i padituri ka qenë në cilësinë e moderatorit të emisionit P., i njëjti ka qenë në cilësinë e shtruesit të pyetjeve dhe jo dhënies së përgjigjeve dhe/apo konstatimeve lidhur me paditësin, apo rasteve

penale të cilat ishin në procedurë e sipër, pra gjitha “citimet” si dhe shpjegimet e aktakuzave të cilave u referohet paditësi, janë bërë nga prokurori i kohës, z. A.Sh., e jo nga i padituri z. B.. Andaj në këtë kuptim, kjo padi është deponuar gabimisht ndaj të paditurit. Ka shtuar se, në rastin konkret - në rastin më të mirë për paditësin, në rast të mos-respektimit të rregullave gazetareske, do të kishim të bënim me shkelje të Kodit të Sjelljes, e assesi me shpifje dhe/apo fyerje. Kësisoj, jo vetëm që i padituri nuk mbahet përgjegjës për shkelje të Kodit të Sjelljes, i njëjti në asnjë rrethanë nuk mund të mbahet përgjegjës as për shkelje të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes ngase ky Ligj nuk ka aplikueshmëri në këtë rast. Nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pathemeltë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përpilimin e përgjigjes në padi shumën prej 325.00 euro dhe për përfaqësim në gjashtë seanca shumën prej 422.50 euro për seancë, e në shumën e përgjithshme prej 2,860.00 euro.

E paditura e tretë K.P.K. përmes përgjigjes në padi, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj, duke shtuar se prokurori i shtetit në rastin konkret ka ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që ka qenë i obliguar t'i ndërmerr me qëllim të vërtetimit të kryerjes së veprës penale si dhe kryesit të kësaj vepre penale. Ka theksuar se, veprimet e Prokurorit të Shtetit janë të mbrojtura me imunitet pasi që në nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit është përcaktuar se *“Prokurorët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni për veprimet e ndërmarra, vendimet e marra, apo mendimet e shprehura që janë brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre”*, dhe në qoftë se Prokurori i Shtetit nuk do ti ndërmerre veprimet e parapara ligjore për hetimin, ndjekjen e kryesve të veprës penale, konsiderohet se i njëjti do të kishte bërë sjellje të pahijshme dhe kjo nënkupton bazë për fillim të procedurës disiplinore ndaj prokurorit. Ka shtuar se, sa i përket emisionit “P.” në televizionin K., emisioni nuk i është dedikuar z. H.H. dhe nuk ka qenë temë Aktakuza kundër z. H.H., por për korrupsionin në përgjithësi e me theks të veçantë korrupsioni në prokurim publik dhe në emision ka pasur edhe panelist tjerë, ku janë shfaqur mendimet lidhur me dukurinë e korrupsionin në përgjithësi dhe për korrupsionin në prokurim publik dhe në asnjë moment nuk është theksuar se z. H.H. është fajtor për korrupsionin në Kosovë, dhe raportet ndërkombëtare mbi perceptimin e korrupsionit në Kosovë janë publike dhe mund të diskutohen në opinion. Në emision, përkatësisht ka fundi i emisionit, prokurori është pyetur për disa raste të korrupsionit në hetim që kanë qenë publike dhe nuk është diskutuar vetëm rasti i z. H.H.. Tutje ka theksuar se, sa i përket pretendimeve të paditësit se janë diskutuar çështjet e aktakuzës pa prezencën e palës kundërshtare, përkatësisht të akuzuarit H.H., nuk është përgjegjësi e KPK-së, se kush nga palët ftohet në emision dhe deklaratimet e prokurorit kanë qenë në kuadër të aktakuzës. Ka deklaruar se të paditurës i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në kontestin lëndor, kjo ngase legjitimiteti real është marrëdhënie e palëve të sajuara në bazë të ndonjë raporti juridiko-civil nga e cila rrjedhin të drejtat subjektive dhe me rastin e cenimit të tyre titullari i së drejtës subjektive të cenuar ka të drejtë të kërkojë mbrojtje ligjore të së drejtës subjektive të cenuar. Në rastin konkret Prokurori i Shtetit nuk ka qenë në ndonjë raport juridiko-civil me paditësin mirëpo, siç është cekur më lartë, Prokurori i Shtetit ka ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë e tij të parapara me Kushtetutën

e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi. Nga gjykata ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi e pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura e katërt K.GJ.K. përmes përgjigjes në padi, në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj, duke shtuar se të njëjtës i mungon baza juridike, dhe se K.GJ.K. ka legjitimitet vetëm në ato raste kur kemi të bëjmë me privim nga liria pa arsye, andaj Kompensimi i dëmit për personat e dënuar ose arrestuar pa bazë, rregullohet me dispozita të veçanta, respektivisht me Kodin e Procedurës Penale. Ka shtuar se, në bazë të dispozitave të kapitullit XXXVI të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht neneve 525 dhe 529, të drejtë kompensimi kanë vetëm personat të cilët në çfarëdo forme padrejtësisht janë privuar nga liria, apo personat të cilët me vendim përfundimtar janë shpallur fajtor ose u është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë, por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë, ose është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar. Nga provat të cilat e paditura i posedon, vërehet se i njëjti nuk ka qenë fare i privuar nga liria, dhe se me vendim përfundimtar është refuzuar akuza ndaj të njëjtit. Tutje, përveç Kodit të Procedurës Penale, as Udhëzimi Administrativ i KGJK-së (04/2015) për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye, nuk parasheh kompensim dëmi për shkak të zhvillimit të procedurës penale. Siç detyrohet nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, KGJK ka hartuar këtë udhëzim, i cili në mënyrë të detajuar parasheh rastet e kompensimit. Sipas këtij Udhëzimi dhe Kodit të Procedurës Penale, lejohet vetëm kompensimi për privim të paarsyeshëm nga liria. Për arsyet e cekura më sipër, e paditura e katërt K.GJ.K., në mbështetje të nenit 525 dhe 529 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe Udhëzimit administrativ 04/2015 për zbatimin e procedurës për kompensimin e dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye, i propozon gjykatës që pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, të merr aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Administrimi i provave dhe vërtetimi i gjendjes faktike

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat: shkrimi i datës 04.12.2014 i publikuar në portalin Indeksonline, Aktgjykimin me numër APS.nr.09/2019 i datës 30.10.2020, Vendimi KPK/nr.202/2018 i datës 30.04.2018, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit acnr.5426/17 i datës 04.11.2020, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit Ac. nr. 2557/13 i datës 17.10.2019, Aktgjykimi i Gjykatës së Themelore C.nr. 3363/13, Ankesa drejtuar KPM-së nga paditësi e datës 26.12.2014, Njoftimi i KPM-së i datës 16.01.2015, së bashku me formularin e ankesës për prokuror, Njoftimi i lëshuar nga PSRK-ja i datës 19.12.2014, Ankesa e datës 15.04.2015 e paraqitur nga paditësi për zyrën e prokurorit disiplinor, Shkresa-deklaratë për media nr.962/14 e datës 23.12.2014, Lajmi i publikuar në gazetën “E...” i datës 23.12.2014, lajmi i publikuar në portalin “K...” i datës 23.12.2014, Ekspertiza e përgatitur nga eksperti neuropsikiatër e datës 27.05.2024, dhe CD-ja e emisionit “P.-K..” e datës 22.12.2014.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin

8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditësit është tërësisht e pa bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga deklarimi i paditësit dhe i të paditurës së parë dhe të paditurit të dytë nuk ishte kontestues fakti se me datën 22.12.2014, në ora 20:15 minuta në televizionin K.. për të cilin televizion është përgjegjës e paditura e parë është mbajtur emisioni me titull “P.”, në të cilin emision i padituri i dytë e kishte intervistuar prokurorin e shtetit A.Sh., dhe persona të tjerë pjesëmarrës në këtë emision. Nuk ishte kontestuese se ndaj paditësit janë zhvilluar procedura penale dhe është ngritur aktakuzë nën dyshimin për kryerjen e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar. E po ashtu, nuk kontestuese se paditësi përmes vendimeve gjyqësore për të gjitha akuzat është liruar nga ndjekja penale, fakte që konstatohen edhe nga vendimet në shkresa të lëndës.

Mirëpo, në mes të palëve ndërgjyqëse përkatësisht paditësit në raport me të paditurën e parë dhe të paditurin e dytë rezulton të jetë kontestues fakti nëse në emisionin e datës 22.12.2014 i shfaqur në emisionin P. të K.-së, për të cilin televizion është përgjegjëse e paditura e parë, i padituri i dytë gjatë intervistimit të prokurorit të shtetit ka bërë shpifje dhe fyerje në drejtim të paditësit. Po ashtu, për të paditurën e tretë dhe të katërt kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë dhe legjitimiteti real pasiv i të njëjtëve për të qenë palë të paditura në këtë procedurë.

Përmes ankesës së datës 26.12.2014 e paraqitur nga paditësi për Komisionin e Pavarur për Media kundër Televizionit K., kryeredaktorit të programit dhe kundër udhëheqësit të emisionit M.B., gjykata konstatoj se paditësi përmes kësaj ankese ka ngritur pretendimet se në emisionin P. të datës 22.12.2014 i transmetuar në K., pa prezencën e paditësit dhe dhënien e mundësisë që të kundërpërgjigjet në pretendimet e ngritura në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, konventat ndërkombëtare dhe ligjet e tjera në fuqi dhe në kundërshtim me etikën e profesionit të prokurorit e ka shpjeguar aktakuzën të cilën e ka hartuar dhe e ka ngritur ndaj ankuesit për publikun e gjerë, shikuesit e televizionit, e cila aktakuzë ende nuk e kishte pranuar paditësi dhe as avokati i tij.

Nga përgjigja e ankesës për paditësin nga Komisioni i Pavarur i Mediave, nga përmbajtja e së njëjtës gjykata konstatoj se me datën 6 janar 2015, Komisioni i ka dërguar K.-së kërkesë për sqarim lidhur me pretendimet e paditësit si palë ankuese. K.. me datën 7 janar 2015, është përgjigjur ndaj kërkesës për sqarim duke theksuar së autori i emisionit “P.” z. M.B., një ditë pas mbajtjes së konferencës për shtyp të organizuar nga ana e juaj, përmes telefonit ju ka ftuar në emision që të ballafaqoheni me akteret e debatit të një ditë me parë. Sipas sqarimit të K.-së, paditësi është përgjigjur se për shkak të pushimeve nuk mund të jem i pranishëm në debat. Po ashtu, nga përmbajtja e së njëjtës, konstatohet se KPM, pas analizimit të përgjigjes së K.-së dhe të gjeturave të monitorimit ka konstatuar së K.. në emision “P.” nuk ka siguruar raportim të drejtë dhe të paanshëm pasi që në kroniken e realizuar nuk ka përfshirë të gjitha palët në kontekst për t'i paraqitur këndvështrimet e tyre, duke vepruar kështu në kundërshtim me Kodin e Sjelljes KKPM-2010/01, respektivisht me nenin 4, paragrafi 2. KPM, duke u bazuar në faktin se K.. ka dështuar të veproj në pajtim me nenin 4, paragrafi 2, të Kodit të Sjelljes, me datën 14 janar 2015, i ka dërguar K.-së Vërejtje përmes të cilës ka kërkuar që përfundimisht të veproj në pajtim me Kodin e Sjelljes në të kundërtën KPM në pajtim me nenin 30 të Ligjit të KPM-së do të ndërmerr masa ligjore ndaj K.-së. Gjithashtu, përmes kësaj përgjigje, paditësi si palë ankuese është udhëzuar të ushtroj të drejtë për reagim në K.. në pajtim me nenin 12, paragrafi 4, të Kodit të

Sjelljes KKPM-2010/01 dhe mediumi është i obliguar që të shqyrtoj kërkesën e juaj për reagim në pajtim me nenin 12 të Kodit të Sjelljes KKPM-2010/01.

Nga formulari i ankesës për prokuror i datës 26.12.2014, gjykata konstatoj se paditësi ka ushtruar ankesë në Zyrën e Prokurorit Disiplinor me pretendimin se prokurori i shtetit A.Sh. në emisionin “P.” të datës 22.12.2014 në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, konventat ndërkombëtare dhe ligjet e tjera në fuqi, e ka shpjeguar aktakuzën të cilën e ka hartuar ndaj paditësit për publikun e gjerë, të cilën aktakuzë paditësi akoma nuk e kishte pranuar, duke kërkuar që ndaj prokurorit të hapet procedura dhe të njëjtit t’i shqiptohet dënimi për shkeljet e shkaktuara.

Nga njoftimi i lëshuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor e datës 27 Mars 2015 sipas ankesës së paditësit, gjykata konstatoj se Zyra e Prokurorit Disiplinor e kishte njoftuar paditësin se me datën 04 dhjetor 2014, përmes një komunikate të lëshuar për media, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, ka informuar opinionin publik për aktakuzën e ngritur kundër disa personave në mesin e tyre edhe dy zyrtarë të OBSH-së. Gjithashtu, ZPD ka gjet se Prokurori A.Sh.ka marr pjesë në emisionin televiziv “P.” me datën 26 dhjetor 2014, ku nga faktet e lartcekura shihet se prokurori A.Sh. ka qenë në emisionin televiziv “P.” ku është deklaruar rreth aktakuzës për rastin në fjalë, 18 ditë pasi që aktakuza është bërë publike në ueb faqen e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Po ashtu, është njoftuar se, hetimi paraprak disiplinor i ZPD-së ka gjet se, prokurori Shala është konsultuar dhe ka marr aprovimin e eprorit të tij, para se të marr pjesë në emisionin e lartpërmendur, duke shtuar se pohimet e juaja nga parashtresa rreth deklaramit të Prokurorit Shala në emisionin televiziv “P.” rreth aktakuzës në rastin konkret nuk arrijnë nivelin e mjaftueshëm për të konstatuar sjelljen e pahijshme dhe se tani për tani nuk ka bazë të mjaftueshme për të hapur një hetim disiplinor për sjellje të pahijshme lidhur me pohimet tuaja nga parashtresa.

Nga ankesa e datës 15.04.2015 gjykata konstatoj se paditësi ka paraqitur ankesë kundër njoftimit të pranuar nga Zyra e Prokurorit Disiplinor, duke e kundërshtuar këtë njoftim dhe duke kërkuar që të vërtetohet fajësia e prokurorit A.Sh. dhe në pajtim me ligjin i njëjti të shpallet fajtor.

Nga deklarata për media e datës 23.12.2014 gjykata konstatoj se paditësi me këtë datë përmes kësaj deklarata kishte kundërshtuar deklaramet në emisionin “P.” të K..-së.

Nga lajmi i publikuar në portalin Koha.net përmes kopjes në shkresa të lëndës gjykata konstatoj se me datë 23.12.2014 i njëjti portal ka publikuar lajmin se “H. nuk jap dorëheqje, thotë se po akuzohet nga grupe të para politikës”. Po ashtu, nga lajmi i publikuar në portalin I... me datë 04.12.2014, përmes shkresës në kopje të lëndës, gjykata konstatoj se i njëjti lajm ka përmbajtjen se ndaj H.H. kryetar i OSHP-së dhe tre të tjerëve ngritët aktakuzë pranë Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Ndërsa, nga lajmi i publikuar në portalin G... E... me datë 23.12.2014, gjykata konstatoj se i njëjti lajm ka përmbajtjen “Kryetari i OSHP-së H.H., ka thënë se nuk do të jap dorëheqje nga posti që mban pasi që nuk dëshiron që këtë institucion ta merr lumi.”

Në cilësi të provës është administruar edhe CD-ja e emisionit “P.” e datës 22.12.2014, për përmbajtjen e së cilës palët ndërgjyqëse nuk kishin vërejtje. Nga e njëjta CD, gjykata konstatoj

se temë e këtij emisionit ka qenë korrupsioni në prokurim publik, dhe se prezent në këtë emision kanë qenë, i padituri i dytë në cilësi të moderatorit të emisionit, prokurori publik A.Sh., zëvendës auditori dhe një pjesëmarrës nga një organizatë jo qeveritare. Gjykata i vlerësoj deklaratimet e të paditurit të dytë të bëra në këtë emision sipas pretendimit të paditësit, përkatësisht mbi pretendimin se i njëjti ka shpifur në drejtim të paditësit në minutën e 48:08 deri 49:20, ku i padituri i dytë konstatohet se e ka pyetur njërin nga personat prezent: *“a keni gjetur keqpërdorim apo keq menaxhim nga OSHP-ja apo të vendimeve të ndryshme,.... për cilin vendim e keni fjalën, për çka bëhet fjalë”*, ndërsa nga minuta e 49:24 deri në minutën 55:22 i paditur i dytë pyet: *“prokuror ju keni ngritur aktakuzë për zotëri H.H., çfarë ka keqpërdorur zotëri H. ?”*, kurse me tutje nga minuta 59:29 deri 59:38 i padituri i dytë pyet: *“po shohim disa nga rastet të cilat i përmendi edhe prokurori special kur tha i kemi hetuar disa a ka pasur aktakuza dhe e di edhe personalisht që edhe personalisht që zotëri prokuror është duke hetuar edhe një rast të një ministri dhe sekretari por kjo nuk mund të bëhet publike pasi që është rast jashtëzakonisht i rëndë, a mendoni që është numër i vogël ky duke ditur se çfarë raporte ndërkombëtare janë duke ardhur ?.”*

Nga ekspertiza psikiatrike e datës 27.05.2024 e përgatitur nga Dr. G.H., gjykata konstaton se eksperti ka arritur në përfundim se paditësi si pasojë e përjetimeve për shkak të fyerjeve, shpifjeve, dhe largimit nga puna që nga muaji dhjetor i 2014 ka pësuar rënie dhe humbje të shumë virtyeteve njerëzore si ato profesionale, prindërore, shoqërore, rënie të shumë funksioneve kongnitive si vullnetit, inteligjencës, koncentrimin, humbjes së raportit në shoqëri, raporteve me rrethin familjar e më gjerë, dëmtim i aftësive prindërore dhe burrnore, humbje dinjitetit dhe përjetimi i pavlerës, kjo rënie ka lanë gjurmë të pa shlyera dhe përherë më të avancuara në psikikën e tij dhe kjo konsiderohet si dhembje shpirtërore me këtë intensitet dhe kohëzgjatje: dhembje shpirtërore e intenzitetit të lartë në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, dhembje shpirtërore e intenzitetit të mesëm prej 1 (një) viti, dhembje shpirtërore të intenzitetit të ulët, është prezent edhe sot dhe do jetë e përjetshme.

Meqenëse, kërkesa e paditësit dhe pretendimet e tij kanë të bëjnë më dy baza nga e njëjta gjendje faktike siç përcaktohet me nenin 255 të LPK-së, përkatësisht ndaj të paditurës së parë dhe të paditurit të dytë në raport me vërtetimin e shpifjes dhe fyerjes dhe kompensimin e dëmit nga e njëjta bazë, kurse në raport me të paditurën e tretë dhe të katërt me kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e procedurës penale, gjykata në vijim të arsyetimit, fillimisht do t'i referohet të paditurës së parë dhe të paditurit të dytë, ndërsa me tutje në raport me të paditurën e tretë dhe të paditurën e katërt.

Baza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës në raport me të paditurën e parë G.K. Sh.P.K. dhe të paditurin e dytë M.B.

Sipas pretendimeve të parashtruara nga palët ndërgjyqëse, gjykata vlerëson se kontesti në këtë rast ka të bëjë me lirinë e shprehjes dhe të drejtës për të bartur informacionin tek publiku në njërin anë nga e paditura e parë dhe i padituri i dytë, dhe të drejtës për mbrojtjen e reputacionit, nderit dhe dinjitetit të paditësit. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se akte të zbatueshme në këtë rast janë dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës Evropiane për të Drejtat

e Njeriut (tani e tutje Konventa), jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (tani e tutje GjEDNJ), dispozitat e Ligjit Nr. 02/L-65 Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (tani e tutje LCKShF) dhe të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tani e tutje LMD), konkretisht:

- a) Neni 40 i Kushtetutës i cili përcakton: *“Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush. Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.”*
- b) Neni 10 i Konventës i cili parasheh se: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t’u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.”*
- c) Neni 3 pika a) i LCKShF i cili shpifjen e përkufizon si: *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”, kursen në pikën b) fyerjen e përkufizon: “Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.”*
- d) Neni 5 paragraf 1, 2 dhe 3 të LCKShF-së përcaktohet se: *“Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjësive në pajtim me këtë Ligj. Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj. Kur shpifja ose fyerja ka të bëjë me një çështje të interesit publik ose kur personi i shpifur ose fyer është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për një pozitë publike, mund të ketë përgjegjësi për shpifje ose fyerje vetëm nëse autori ka ditur se informacioni ka qenë i rrejshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij.”*
- e) Neni 7 i LCKShF-së parasheh se: *“Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mire, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla.”*
- f) Neni 183 paragraf 1 të LMD-së përcakton se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për*

dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.”

Fillimisht, gjykata vlerëson se e drejta e lirisë së shprehjes dhe e informimit të publikut është një e drejtë themelore për një shoqëri demokratike. Por, në emër të kësaj të drejte nuk mund të ndërhyhet dhe cenohet e drejta e individit dhe kufizimi vendoset kur kjo e drejtë prek moralin, nderin, dinjitetin personalitetin dhe të drejtat e individit (*Caste of White kundër Suedisë* vendim i GjEDNj-së i datës 19 shtator 2006). Në lidhshmëri me këtë, nga interpretimi i nenit 40 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 10 të Konventës, vlerësohet se mund të ndërhyhet në ushtrimin e lirisë së shprehjes, kur plotësohen 3 kushte së bashku, dhe atë ndërhyrja duhet të parashikohet me ligj (parimi i ligjshmërisë), ndërhyrja duhet të ketë si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose të drejtat e parashikuara (parimi i legjitimitetit), dhe ndërhyrja duhet të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike (parimi i proporcionalitetit).

Sipas praktikës së jurisprudencës së GjEDNj-së e cila në rastin *Dalban kundër Rumanisë*, vendim i datës 28.09.1999, kishte mbajtur qëndrimin se shtypi ka një funksion thelbësor në një shoqëri demokratike, por nuk duhet të kapërcejë disa kufij, veçanërisht në lidhje me reputacionin dhe të drejtat e të tjerëve dhe nevojën për të parandaluar zbulimin e informacionit konfidencial, megjithatë detyra e tij është të japë – në një mënyrë në përputhje me detyrimet dhe përgjegjësitë e tij – informacion dhe ide për të gjitha çështjet me interes publik. Në lidhshmëri me këtë, gjykata vlerëson se e drejta për të informuar publikun, mbaron aty ku fillon e drejta e individit që të cenohet në mënyrë të paligjshme në nderin, personalitetin, reputacionin, jetën private nga thënie fyese dhe shpifëse. Njëkohësisht, në rastin e deklarimeve të pavërteta, dëmi që i vjen të dëmtuarit është shumë herë më i madh, se përfitimi që mund të ketë shoqëria nga përdorimi pa kufij i lirisë së shprehjes. Kufizim i të drejtës së shprehjes bëhet deri në kufijtë që fjalët dhe thëniet e personit nuk përmbajnë elementet të shpifjes apo fyerjes.

Nga deklarimi i vet paditësit dhe nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi ka qenë kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit, dhe rrjedhimisht i njëjti ka qenë një person i njohur për publikun nga pozita të cilën e ka mbajtur. Në lidhshmëri me këtë, gjykata vlerëson se duke bartur një funksion publik, i njëjti është subjekt i kufijve më të gjerë të kritikës së pranueshme sesa individët privatë të cilët nuk kanë bartur asnjëherë ndonjë funksion publik (*Kulis kundër Polonisë* vendim i GjEDNJ i datës 18.06.2008).

Mbi bazën e deklarimeve dhe pretendimeve të paditësit në raport me të paditurën e parë dhe të paditurin e dytë, pretendimi i paditësit ka të bëjë me emisionin e titulluar “P.” i shfaqur në televizionin e të paditurës së parë me datë 22.12.2014. Paditësi pretendimet e tij në raport me shpifjen dhe fyerjen kryesisht i ka ngritur në deklaratimet e të paditurit të dytë dhe prokurorit të shtetit pjesëmarrës në këtë emision, duke pretenduar se i padituri i dytë në cilësi të moderatorit

të emisionit i ka dhënë mundësinë prokurorit të shtetit, por pa prezencën e paditësit, që të kundërpërgjigjet në pretendime të ngritura, në kundërshtim me dispozitat kushtetuese, konventat ndërkombëtare, në kundërshtim me ligjet në fuqi, dhe në kundërshtim me etiken e profesionit të prokurorit, ka shpjeguar aktakuzën të cilën e ka hartuar dhe e ka ngritur ndaj paditësit për publikun audiencën e gjerë, shikuesit e televizionit, të cilën aktakuzë ende nuk e ka pranuar paditësi, dhe as avokati i paditësit, dhe se vendi i shqyrtimit të pretendimeve të aktakuzës është gjykata dhe jo televizioni, i cili ka lejuar emetimin e emisionit bashkë me personin përgjegjës si autor i emisionit.

Kurse, me tutje paditësi pretendon se i padituri i dytë ka shpifur në të njëjtin emision në raport me të duke ju referuar edhe kohës përmes minutave konkret të deklarimeve, ku gjykatës nga përmbajtja e deklarimeve përmes administrimit të CD-së, i rezultojë se, në minutën e 48:08 deri 49:20, i padituri i dytë e ka pyetur njërin nga personat prezent: *“a keni gjetur keqpërdorim apo keq menaxhim nga OSHP-ja apo të vendimeve të ndryshme,.... për cilin vendim e keni fjalën, për çka bëhet fjalë”*, ndërsa nga minuta e 49:24 deri në minutën 55:22 i paditur i dytë pyet: *“prokuror ju keni ngritur aktakuzë për zotëri H.H., çfarë ka keqpërdorur zotëri H. ?”*, kurse me tutje nga minuta 59:29 deri 59:38 i padituri i dytë pyet: *“po shohim disa nga rastet të cilat i përmendi edhe prokurori special kur tha i kemi hetuar disa a ka pasur aktakuza dhe e di edhe personalisht që edhe personalisht që zotëri prokuror është duke hetuar edhe një rast të një ministri dhe sekretari por kjo nuk mund të bëhet publike pasi që është rast jashtëzakonisht i rëndë, a mendoni që është numër i vogël ky duke ditur se çfarë raporte ndërkombëtare janë duke ardhur ?”*

Gjykata sjell në vëmendje përkufizimin e shpifjes sipas LCKShF-së, sipas të cilit përkufizim: *“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër.”* Nga përmbajtja e kësaj dispozite del se, për të konstatuar se është kryer shpifja, duhet të përmbushen në mënyrë komulative këto kushte: shpifja të kryhet me përhapjen e deklaratave apo informacioneve të tjera, deklaratat ose informacionet të jenë të pavërteta, deklaratat apo informacionet e tjera të jenë konkrete, deklaratat apo informacionet të jenë diskredituese për reputacionin e personit dhe deklaratat apo informacionet e pavërteta të përhapura duhet të dihen nga autori se të njëjtat janë si të tilla. Gjykata vlerëson se mungesa e njërit prej këtyre kushteve, paraqitet si shkak për përjashtimin e përgjegjësisë nga kryerja e shpifjes. Ndërsa, LCKShF fyerjen e përkufizon: *“Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese.”* Nga përmbajtja e kësaj dispozite del se, akti i fyerjes ka të bëjë me dhënien e deklaratave të rreme ose të pavërteta rreth një personi tjetër, deklarata të cilat konsiderohen nënçmuese dhe kanë për qëllim të dëmtojnë reputacionin e tij në publik.

Në rastin konkret, duhet të behët dallimi nëse deklaratimet e bëra nga i padituri i dytë e të shfaqura në emisionin për të cilin është përgjegjëse e paditura e parë, kanë qenë deklaratime në formë të pyetjeve me qëllim të vlerësimit të situatës në vend, apo deklaratime, të cilat përmbajnë elemente të shpifjes. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pyetjet e parashtruara apo opinionet janë pikëpamje personale mbi një ngjarje apo situatë, vlerësime të cilat nuk mund të dëshmojnë dhe nuk kanë detyrimin që të provohen, kurse faktet janë situata të provuara, të cilat mund të dëshmojnë dhe

para deklarimit duhet t'i jenë nënshtruar verifikimit për vërtetësinë e tyre. Në rastin e lartcekur, *Dalban kundër Rumanisë*, vendim i datës 28.09.1999, GjEDNJ ka bërë dallimin në mes të deklarimit të fakteve, të cilët mund të provohen dhe opinioneve (gjykimeve vlerësuese), që për nga natyra nuk mund të provohen, për çdo rast, ato duhet të veçohen me kujdes. Sipas vlerësimit të GjEDNJ-së në këtë rast, ekzistenca e fakteve mund të dëshmohet, ndërsa vlerësimet, opinionet apo mendimet nuk mund të jenë objekt i të provuarit, pasi kjo do të cenonte lirinë e shprehjes.

Nga vlerësimi dhe analizimi i deklarimeve të paditurit të dytë në emisionin "P." nga CD-ja e cila është pjesë e shkresave të lëndës, përkatësisht: *"a keni gjetur keqpërdorim apo keq menaxhim nga OSHP-ja apo të vendimeve të ndryshme, për cilin vendim e keni fjalën, për çka bëhet fjalë"*, *"prokuror ju keni ngritur aktakuzë për zotëri H.H., çfarë ka keqpërdorur zotëri H.?"*, *"po shohim disa nga rastet të cilat i përmendi edhe prokurori special kur tha i kemi hetuar disa a ka pasur aktakuza dhe e di edhe personalisht që edhe personalisht që zotëri prokuror është duke hetuar edhe një rast të një ministri dhe sekretari por kjo nuk mund të bëhet publike pasi që është rast jashtëzakonisht i rëndë, a mendoni që është numër i vogël ky duke ditur se çfarë raporte ndërkombëtare janë duke ardhur?"* të shfaqura në televizionin për të cilin është përgjegjëse e paditura e parë, e në përputhje me dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata konstatoj se të njëjtat deklarime janë paraqitur në formë të pyetjeve dhe asnjëra prej tyre, në përmbajtjen e tyre nuk përmban shpifje e as fyerje, të njëjtat janë paraqitur me qëllim të informimit të publikut, në raport me vlerësimin mbi një temë të caktuar. Rrjedhimisht, gjykata konstatoj se nuk plotësohen asnjëri nga kushtet ligjore të cilat e përkufizojnë shpifjen dhe fyerjen dhe njëkohësisht mungojnë edhe elementet e tyre.

Kurse në raport me deklaratat e personave të tjerë prezent në këtë emision, përkatësisht pretendimin e paditësit se i padituri i dytë e ka lejuar prokurorin e shtetit prezent në emision që i njëjti të shpalojë aktakuzën, ndërsa e paditura e parë e ka mundësuar përmes këtij emisioni, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë është i paqëndrueshëm. Kjo për faktin se, sipas nenit 11 paragraf 1 të LCKShF-së, ku përcaktohet se: *"Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë për të cilën ai ose ajo nuk kanë qenë autor, redaktor ose botues dhe ai ose ajo nuk kishin dijeni, dhe nuk ekziston arsye të besohet, se ai ose ajo kontribuan në përhapjen e shpifjes dhe fyerjes."* andaj, në lidhshmëri me këtë, gjykata vlerëson se e paditura e parë dhe i padituri i dytë nuk mund të mbahen përgjegjës në raport me pretendimin për shpifjen dhe fyerjen, kur e njëjta pretendohet se është kryer nga persona të tjerë, përkatësisht të njëjtit nuk kanë qenë autor të këtyre deklarimeve. Ndërsa, dispozita e nenit 5 paragraf 2 të LCKShF-së, e cila parasheh se: *"Për shpifjen ose fyerjen e kryer përmes subjekteve mediale, personat që vijojnë janë bashkëpërgjegjës ose përgjegjës individual: autori, redaktori, ose publikuesi apo dikush që ndryshe nga ata ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e saj"*, nuk mund të zbatohet në rastin konkret. Kjo për faktin se, e njëjta dispozitë e parasheh përgjegjësinë për shpifjen dhe fyerjen e kryer përmes mediave në raport të autorit me redaktorin apo publikuesin apo personat e tjerë të cilët ushtrojnë kontroll mbi të. Kurse në rastin konkret, lidhur me deklaratat e prokurorit në emisionin për të cilin pretendon paditësi, në këtë rast prokurori nuk është në raport me asnjërin prej rasteve të cilat parashihen me dispozitën sikurse me lartë. Dhe rrjedhimisht, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin dhe analizimin e deklaratave të tyre, për faktin se të njëjtit nuk janë palë në këtë procedurë, dhe se e paditura e parë si përgjegjëse e emisionit nuk mund të mbahet

përgjegjëse për deklaratimet e personave të tjerë pjesëmarrës në emision, e as i padituri i dytë.

Në raport me pretendimet e paditësit, i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, konventa ndërkombëtare dhe ligjet në fuqi, mirëpo i njëjti nuk shpjegon konkretisht se si ka ardhur deri të shkelja e këtyre të drejtave të garantuara. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se vetëm referimi dhe përmendja e kushtetutës, konventave dhe ligjeve në fuqi, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese apo ligjore. Në këtë rast pala paditëse, lidhur me këtë pretendim nuk ka arritur të argumentoj faktin se e paditura e parë dhe i padituri i dytë kanë vepruar në kundërshtim me Kushtetutën, konventat apo ligjet në fuqi.

Sipas interpretimit të dispozitave të lartcekura, duke marr për bazë edhe jurisprudencën e GjEDNj-së, pas analizimit dhe vlerësimit të deklaratimeve të paditurit në raport me pretendimet e paditësit, gjykata konstaton se kërkesa e paditësit në raport me konstatimin e shpifjes dhe fyerjes është e pa bazuar, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në raport me këtë bazë.

Baza ligjore dhe vlerësimi i gjykatës në raport me të paditurën e tretë K.P.K. dhe të paditurën e katërt K.G.J.K.

Mbi bazën e pretendimeve të paditësit lidhur me të paditurën e tretë dhe të paditurin e katërt, gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (tani e tutje KPP), i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi pretendon se i është shkaktuar dëm nga të paditurit, dhe dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Fillimisht, në raport me të paditurën e tretë K.P.K., gjykata vlerëson se të njëjtës i mungon legjitimiteti pasiv në këtë procedurë, për faktin se sipas nenit 109 paragraf 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: *“Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë veprë penale ose për ndonjë veprë tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.”* Me tutje, me Ligjin Nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit në nenin 7 të tij përcaktohen detyrat dhe kompetencat e prokuroreve, ku ndër të tjera parashihet edhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale. Mbi bazën e këtyre dispozitave, gjykata vlerëson se prokurori i shtetit është i autorizuar të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore lidhur me hetimin e veprave penale, dhe njëkohësisht i njëjti nuk mund të mbahet përgjegjës në aspektin civil për veprimet e ndërmarra. Gjukata vlerëson se, prokurori i shtetit gjatë hetimit dhe ndjekjes së veprave penale, vepron brenda autorizimeve ligjore, ndërsa nëse i njëjti vepron në kundërshtim me këto autorizime, atëherë mbahet përgjegjës në aspektin individual dhe ndjeket procedurë tjetër, sikurse në rastin konkret ku nga shkresat e lëndës paditësi ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj prokurorit të rastit. Ndërsa, me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet përgjegjësia civile, përkatësisht detyrimi për kompensimin e dëmit, nëse rezulton se personi i ndjekur penalisht është liruar nga akuza, dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë mungon edhe raporti materialo – juridik në mes të paditësit dhe të paditurës, në këtë rast K.P.K. Mirëpo, sipas nenit 529 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës parashihet e drejta e kompensimit të dëmit për personat për privim pa bazë nga liria, e për të cilën është i legjitimuar

K.GJ.K.i cili në këtë procedurë është i padituri i katërt, e për të cilën gjykata do të jap arsyetimin si me poshtë.

E drejta e kompensimit të dëmit për personat e ndaluar apo të arrestuar në kundërshtim me dispozitat ligjore, garantohet me Kushtetutën e Kosovës, e cila në nenin 29 paragraf 5 përcakton se: *“Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.”* Ndërsa sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila sipas nenit 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është e zbatueshme drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës, me nenin 5 paragraf 5 të saj parashihet se: *“Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.”* Njëkohësisht, Protokollin Nr.7 i kësaj Konvente, në nenin 3 përcakton që: *“Kur një person është dënuar për një vepër penale me vendim të formës së prerë dhe kur ky dënim është anuluar më vonë, ose në rast faljeje, për shkak të një fakti të ri ose të zbuluar rishtazi që provon një gabim gjyqësor, personi që ka pësuar ndëshkimin për arsye të këtij dënimi, zhdëmtohet sipas ligjit ose praktikës në fuqi në Shtetin në fjalë, me përjashtim të rastit kur është provuar se moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej personit në fjalë.”*

Me tuje, lidhur me çështjen e të drejtës në kompensim dëmi për gjykim të paarsyeshëm, me nenin 525 të Kodit Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, parashihet se: *“1. Të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste: 1.1. kur pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ndodhur për arsye se në procedurën e re i dëmtuari është tërhequr nga propozimi si rezultat i marrëveshjes me të pandehurin; ose 1.2. kur në procedurën e rishikimit me aK..endim është refuzuar akuza për shkak të moskomptencës së gjykatës, e paditësi i autorizuar e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente. 2. I dënuari nuk ka të drejtë në kompensim dëmi në qoftë se me pohimin e tij të rremë ose në mënyrë tjetër ka shkaktuar me qëllim dënimin e tij, përveç kur për këtë ka qenë i detyruar. 3. Në rast të dënimit për vepra penale në bashkim, e drejta në kompensim dëmi ekziston për veprën penale për të cilën plotësohen kushtet për njohjen e kompensimit.”*

Kurse, nga neni 529 i të njëjtit Kod, përcakton që: *“E drejta në kompensim dëmi i takon gjithashtu: 1.1. personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aK..endim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar; 1.2. personit i cili ka mbajtur dënimin me heqje të lirisë dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i është shqiptuar dënim me burgim më të shkurtër nga dënimi të cilin e ka mbajtur, apo i është shqiptuar saksion penal pa heqje të lirisë ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi; 1.3. personit i cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi është arrestuar pa arsye ose është mbajtur një kohë në paraburgim apo në një institucion korrektues për mbajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar; dhe 1.4. personit i cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa dënimi me burgim për të cilin është gjykuar.”*

2. Personi i cili sipas nenit 163 të këtij Kodi është arrestuar pa bazë ligjore, i takon e drejta në kompensim dëmi në qoftë se kundër tij nuk është caktuar paraburgimi ose nëse koha e arrestit nuk i është llogaritur në dënimin e shqiptuar për veprën penale ose kundërvajtje. 3. Kompensim dëmi nuk i takon personit i cili me veprimet e tij të palejueshme ka shkaktuar arrestimin. Në rastet nga paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1 dhe 1.2. të këtij neni përjashtohet e drejta në kompensim dëmi kur ekzistojnë rrethanat nga neni 525, paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1. dhe 1.2. të këtij Kodi. 4. Në procedurën për kompensimin e dëmit në rastet e parapara në paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, dispozitat e këtij kapitulli zbatohen përshtatshëm. Me tutje, neni 527 paragraf 2 i këtij Kodi parasheh se: “Padia për kompensim dëmi paraqitet kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore.”

Ndërsa, në rastet kur pretendohet cenimi i autoritetit dhe liritë e të drejtave të personalitetit me nenin 183 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.”

Nga përmbajtja e dispozitave të lartcekura, gjykata vlerëson se në rastet e kërkesave për kompensimin e dëmit mbi bazën e cenimit të lirisë dhe të drejtave të personalitetit, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale paraqiten se “*lex specialis*”, ndërsa dispozitat e LMD-së, shërbejnë në funksion të specifikimit të formave të dëmit dhe gjykimit të kompensimit për këto forma, gjithnjë nën kushtin që plotësohen kriteret e kërkuara me dispozitat e ligjit special (Kodit të Procedurës Penale).

Sipas dispozitave të lartcekura, e në përputhje me provat e administruara në këtë çështje kontestimore, fillimisht gjykata do të vlerësojë nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara me nenin 525 të KPP-së. Kjo dispozitë garanton të drejtën e kompensimit të dëmit për dënim të paarsyeshëm në dy raste: a) kur ndaj subjektit të caktuar shqiptohet sanksion penal i formës së prerë dhe b) kur subjekti i caktuar është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi. Në të dyja rastet, dispozita ligjore e lartcekur e kërkon që në një fazë të mëvonshme, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e rishikuar është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar.

Në rastin konkret, në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi i është nënshtruar procedurave gjyqësore, ka qenë i akuzuar për veprën penale “*Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar*” dhe në fund është liruar nga të gjitha akuzat penale. Në këtë mënyrë, rezulton se ndaj paditësit, në asnjë fazë të procedurës penale nuk është shqiptuar sanksion penal i formës së prerë. Po ashtu, i njëjti në asnjë rast nuk rezulton të jenë shpallur fajtorë dhe liruar nga dënimi, e që më vonë sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, ndaj të njëjtit procedura e rishikuar të jetë pushuar në formë të prerë, ose me aktgjykim të formës së prerë sipas këtij mjeti është liruar nga akuza ose akuza të jetë refuzuar. Nga vetë formulimi i dispozitave të lartcekura të Kodit të Procedurës Penale, Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me Protokollin Shtesë Nr.7, si kriter bazik për tu njohur e drejta në

kompensim dëmi, është përcaktuar ekzistimi i një aktgjykimi dënues të formës së prerë për një vepër penale, respektivisht posedimi i cilësisë së “të dënuarit”, për subjektin të cilit i takon kompensimi. Në lidhshmëri me këtë, gjykata iu referua përkufizimeve të përcaktuara me nenin 19 të KPP-së, ku në paragrafin 1, pika 1.6 është përcaktuar: *“Shprehjet e përdorura në këtë Kod të Procedurës Penale kanë këto kuptime: Person i dënuar - personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale.”* Meqenëse në rastin konkret paditësi nuk ka qenë i dënuar, gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara me dispozitën nga neni 525 të KPP-së, për të gjykuar apo njohur kompensimin.

Tutje, gjykata e vlerësoj kompensimin i cili garantohet sipas dispozitës së nenit 529 të KPP-së, e cila i referohet të drejtës në kompensim për heqje të lirisë pa bazë. Dispozita e lartcekur i ka numëruar në mënyrë taksative të gjitha situatat të cilat konsistojnë në privim nga liria, e të cilat e formësojnë bazën për gjykimin e kompensimit ndaj subjekteve të cilët janë privuar nga njëra prej të drejtave më bazike dhe fundamentale. Në rastin konkret, në bazë të provave të administruara të cilat gjenden në shkresa të lëndës, sipas vlerësimit të gjykatës nuk është provuar fakti se paditësi gjatë rrjedhës së procedurës penale, në të cilën ka qenë palë, i është nënshtruar ndonjërit prej kufizimeve të përcaktuara nga dispozita e lartcekur. Për më tepër, i njëjti nuk ka ngritur fare pretendime në këtë drejtim. Mbi këtë bazë, ngjashëm sikurse me situatën paraprake, nuk janë plotësuar as kriteret e kërkuara me dispozitën nga neni 529 të KPP-së për tu gjykuar apo njohur kompensimi në dobi të paditësit.

Gjykata nuk e përjashton faktin që paditësi, duke qenë subjekt i një procedure penale në cilësinë e të pandehurit, gjatë rrjedhës së procedurës mund të kenë përjetuar frikë, pasiguri dhe ankth, respektivisht të jenë ballafaquar me një gjendje të rënduar emocionale, siç nuk përjashtohet edhe fakti i njëjti, si pasojë e procesit gjyqësor mund të jenë dëmtuar në aspektin material - pasuror. Gjykata vlerëson se, në procedura të kësaj natyre, kur kërkesa për kompensim është e drejtuar ndaj autoriteteve publike si në rastin konkret ndaj K.GJ.K., krahas konstatimit të dëmit, duhet të provohet edhe baza e përgjegjësisë për kompensim. Fakti që ndaj paditësit është zhvilluar procedurë penale, nuk e arrin standardin e nevojshëm për ta bërë apriori përgjegjëse palën e paditur për kompensim. Gjykata vlerëson se sistemi gjyqësor, është i detyruar që të procedojë sipas aktakuzës së inicuar nga organi që ushtron ndjekjen penale, të udhëheq procedurën sipas rregullave të përcaktuara dhe mbi bazën e provave të cilat i vihen në dispozicion, në raport edhe me aplikimin e ligjit material, të merr një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në raport me çështjen e ngritur.

Gjykata mori në konsideratë pretendimet e paditësit i cili pretendon se e paditura me proceduara të pa bazuara në prova, të tej zgjatura në kohë kanë shkaktuar dëme shpirtërore të paditësi i cili është shtrënguar të jap dorëheqjeje të pa revokueshme nga pozita që ka mbajtur dhe është ballafaquar me procedura disa vite me radhë për të cilat me vendime përfundimtare gjyqësore është shpallur i pafajshëm. Mirëpo, në raport me pretendimet e tilla, gjykata sjellë në vëmendje faktin se në procedurë penale është i njohur parimi i *“presumimit të pafajësisë”*, si një parim fundamental i së drejtës, që shërben si garanci që çdo person i dyshuar ose që akuzohet për vepër penale duhet të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.

Në këtë mënyrë, vlerësimi përfundimtar i gjykatës konsiston në faktin që meqenëse nuk janë përmbushur kriteret e kërkuara për të krijuar bazën për kompensim konform dispozitave të lartë cituara të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, i cili shërben si *“lex specialis”*, e paditura e katërt K.GJ.K. nuk mund të cilësohet përgjegjëse për dëmin e pretenduar ndaj paditësve. Rrjedhimisht, nuk mund të gjykohej çfarëdo forme e kompensimit të dëmit material apo jo material për paditësin konform dispozitave nga nenet 136, 169 dhe 183 të LMD-së, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit duke e refuzuar në tërësi të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit në raport me të paditurën e katërt K.GJ.K...

Gjykata e kishte parasysh edhe dispozitën nga neni 526 par.2 të KPP-së, e cila parasheh që: *“Para se të paraqesë padinë në gjykatë për kompensim dëmi, i dëmtuari kërkesën e tij ia drejton organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore për arritjen e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit, llojin dhe lartësinë e kompensimit.”* Në funksion të njëjtë, dispozita nga neni 527 paragraf 1 përcakton: *“Kur kërkesa për kompensim dëmi nuk miratohet ose organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore dhe i dëmtuari nuk arrijnë marrëveshje brenda tre (3) muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padinë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente. Nëse arrihet marrëveshje vetëm për një pjesë të kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padi për pjesën tjetër të kërkesës.”* Dispozitat e lartcekura e parashohin paraprakisht zhvillimin e procedurës administrative, përmes paraqitjes së kërkesës për kompensim pranë organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, me synimin e arritjes së një marrëveshje për kompensim. Në anën tjetër, procedura gjyqësore është paraparë të vijë në shprehje vetëm si fazë e dytë, në situatën kur është dështuar arritja e një marrëveshjeje në fazën e parë. Në rastin konkret, nga thëniet e palëve ndërgjyqëse, në ndërlidhje me provat e administruara, gjykatës i rezultoi se nuk është ndjekur fare procedura administrative para inicimit të procesit gjyqësor përmes ushtrimit të padisë. Megjithatë, bazuar në faktin se paditësi, nga arsyet e dhëna më lartë, nuk është legjitimuar që kërkesën për kompensim të drejtojë ndaj të paditurës si organ publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, dështimi për të ndjekur procedurën e paraparë me nenin 526 të KPP-së, nuk është me ndikim në vlerësimin e pozicionit të të njëjtëve në këtë procedurë.

Në raport me ekspertizën nga lëmia e psikiatrisë, gjykata e trajtoi përmbajtjen dhe të gjeturat e kësaj ekspertize, me ç'rast erdhi në përfundim se e njëjta është përpiluar në kuadër të standardeve dhe parametrave të kërkuara profesionale. Megjithatë, bazuar në faktin se vlerësimi përfundimtar i gjykatës konsiston në qëndrimin që paditësit i mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë, të gjitha provat e administruara në këtë procedurë, e me të cilat determinohet çështja e lartësisë së kërkesëpadisë, nuk janë relevante dhe me peshë të veçantë në drejtim të krijimit të argumentimit për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Shpenzimet e procedurës

Vendimin që pala paditëse t'i bart shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 452 të LPK-së, sipas se cilës: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqësor, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore.”* Ndërsa, lartësinë e shpenzimeve të procedurës gjykata e bazoi në Tarifën

e Odës së Avokatëve, dhe atë për të paditurën e parë dhe të paditurin e dytë për pjesëmarrje në gjashtë seanca gjyqësore për secilin të paditur shumë prej 422.50 euro për seancë, si dhe për të dy të paditurit për përgjigje në padi shumë prej 325.00 euro për secilin, e në shumë të përgjithshme prej 2,860.00 euro për secilin. Ndërsa, për seancën e datës 02.08.2023, për faktin se e njëjta nuk ishte mbajtur pa fajin e paditësit.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e në përputhje me nenin 160 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.493/2015, datë 29.01.2025

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.